



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLIA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot No.	05-737
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-4-
Data: Datum: Date: 05/02/2026	
Prishtinë / a	

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE / PSO

EMRI I PSO: PËRDORIMI DHE MIRËMBAJTJA E INKUBATORIT NË LABORATOR
(BIO-P02/V1.0)

PËRMBAJTJA: PSO PËRMBAN HAPAT KONKRET PËR PËRDORIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E INKUBATORIT NË LABORATOR

VERSIONI:1.0
DATA E APROVIMIT: 03/02/2026
AUTOR: MSh/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VIII
NR. I NËNHAPAVE:36

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë



QËLLIMI	KJO PSO KA PËR QËLLIM TË SHPJEGOJË HAPAT E PROCEDURËS PËR PËRDORIMIN, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E INKUBATORIT NË LABORATORIN E MIKROBIOLOGJISË PËR TË SIGURUAR INKUBIMIN E SAKTË DHE TË SIGURT TË KULTURAVE MIKROBIOLOGJIKE. INKUBATOR: PAJISJE QË MBAN KUSHTE TË KONTROLLUARA MJEDISORE (TEMPERATURË, LAGËSHTI, CO ₂) PËR KULTIVIMIN E KULTURAVE MIKROBIALE.
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> - LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE; - PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORËT 2024-2030; - DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË;
LISTA E SHKURTESAVE	<ul style="list-style-type: none"> - PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE - PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave të biosigurisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kjo procedurë zbatohet nga i gjithë personeli laboratorik që përdor inkubatorin për kultivimin e mikroorganizmave; 2. Menaxheri i laboratorit siguron që kjo procedurë të zbatohet si dhe inkubatori të mirëmbahet rregullisht; 3. Të gjithë punonjësit duhet të trajnohen në përdorimin e duhur dhe mirëmbajtjen e Inkubatorit para fillimit të punës në laborator.
[II]	Materialet dhe pajisjet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Inkubator laboratorik (elektrik, termostatik apo CO₂); 2. Termometër (nëse nevojitet monitorim i jashtëm); 3. Pjata, tuba me medime kultivuese; 4. Pajisje për etiketim (markues, letër ngjitëse etj.); 5. Regjistër ose sistem regjistrimi elektronik.
[III]	Masat e sigurisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorni gjithmonë pajisjet personale mbrojtëse (PPM-në, pelerinë laboratorit, doreza, maskë); 2. Mos mbingarkoni inkubatorin; 3. Sigurohuni që të gjitha kulturat të jenë të etiketuara dhe të mbyllura siç duhet; 4. Monitoroni rregullisht për ndotje ose rrjedhje; 5. Ndiqni udhëzimet dhe protokollet e biosigurisë gjatë punës me patogjenë. 6. Masat e tjera të nevojshme: <ol style="list-style-type: none"> a. Thonjtë të jenë të shkurtë; b. Të mos mbahen aksesorë gjatë punës në laborator; c. Flokët e gjatë të jenë të lidhura që të mos pengojnë procesin e punës.
[IV]	Procedura para përdorimit të inkubatorit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurohuni që inkubatori të jetë i pastër dhe pa ndotje apo derdhje; 2. Verifikoni që temperatura e vendosur është ajo e kërkuar për inkubim (zakonisht 25°C, 30°C, 37°C, ose temperaturën e synuar); 3. Prisni që inkubatori të arrijë temperaturën e duhur para se të vendosni kulturat; 4. Regjistroni datën, orën, temperaturën dhe inicialet tuaja në regjistrin e përdorimit.

[V]	Vendosja e kulturave në inkubator	<ol style="list-style-type: none"> 1. Etiketoni/shenjëzoni të gjitha pjatat/tuba me emrin e mostrës, datën dhe inicialet; 2. Vendosini kulturat në raftet e inkubatorit në mënyrë të barabartë duke lënë hapësirë për qarkullimin e ajrit; 3. Shmangni vendosjen e pjatave njëra mbi tjetrën, përveçse në rastet kur përdorni mbajtëse të posaçme; 4. Mbyllni derën e inkubatorit mirë; 5. Mos e hapni shpesh inkubatorin – kjo shkakton luhatje të temperaturës; 6. Përdorni dritaren e shikimit ose termometrin e jashtëm për monitorim; 7. Regjistroni temperaturën të paktën dy herë në ditë gjatë inkubimit.
[VI]	Largimi i kulturave nga inkubatori	<ol style="list-style-type: none"> 1. Largoni me kujdes kulturat pas përfundimit të periudhës së inkubimit; 2. Inspektoni për ndotje, cilësi të rritjes apo ndonjë anomali; 3. Dezinifektoni inkubatorin nëse ka pasur ndotje apo derdhje; 4. Fikni inkubatorin nëse nuk do të përdoret për një kohë të gjatë (sipas politikave të laboratorit).
[VII]	Mirëmbajtja e inkubatorit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pastroni sipërfaqet e brendshme me etanol 70% ose dezinfektues çdo javë; 2. Kontrolloni dhe kalibroni termostatin çdo muaj ose sipas nevojës; 3. Bëni servis profesional një herë në vit (apo sipas udhëzimeve të prodhuesit); 4. Dokumentoni të gjitha aktivitetet e pastrimit dhe mirëmbajtjes.
[VIII]	Dokumentet dhe regjistrimet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistri i përdorimit të inkubatorit; 2. Regjistri i monitorimit të temperaturës; 3. Regjistri i mirëmbajtjes dhe kalibrimit;